



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 94-Prill 2011 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/>
www.malisheva-komuna.org



Përmbajtja

Filloi procesi i regjistrimit në Malishevë	2
Shënohet Dita e Ambientit.....	3
Prilli muaj i ambientit	4
Kryetari Kilaj priti në takim njohës zyrtarin e lartë të OSBE-s për regjionin e Prizrenit	4
Kryetari Kilaj shpërblen me llaptop fituesin Islam Foniqi	5
Tentim vetëvrasjet mbeten shqetësim	6
Për shkak të mospërgjegjësisë ndaj premtimeve 10-vjeçare ndërpritet bashkëpunimi me PELIKAN-in francez	7
Mbahet takimi i parë i KOZ-it	7
Prezantohet studimi në sektorin e turizmit: specialist i turizmit dhe kuzhinier	8
Përfundon me sukses regjistrimi në Malishevë	9
KPF i rekomandoi kuvendit projekt rregulloren për zgjedhje	10
Qeveria e shtetit ndihmon Malishevën në masat parandaluese kundër etheve hemorragjike	10
U mbajt seminari për vlerësimin e rreziqeve dhe planeve kontingjente.....	10
Hapet rruga për zgjedhjet nëpër fshatra	11

Filloi procesi i regjistrimit në Malishevë

Malishevë, 1 prill

Sot, ka filluar procesi i regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, në 120 qarqe të Komunës së Malishevës, ndërsa procesi i regjistrimit ka filluar mbarë dhe sipas planit të paraparë, në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

“Që nga sot e deri në përfundim të këtij procesi, 120 regjistruar do të jenë në terren për të bërë regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave”, ka thënë z.Muharrem Morina, nga Komisioni Komunal i Regjistrimit.

“Për këtë proces, janë të angazhuar 120 regjistruar standard, ndërsa 12 të tjerë janë rezervë, në rast të ndonjë mungese që mund të ndodhë”, ka sqaruar z.Morina, ndërsa “120 regjistruar janë trajnuar paraprakisht”.

Morina, shprehu besimin se regjistrimi do të kryhet brenda afatit dhe në kuadër të kornizave ligjore.

Në Malishevë

Shënohet Dita e Ambientit

Malishevë, 1 prill



Me anë të një aksioni për pastrimin e ambientit në qytetin e Malishevës, është shënuar 1 prilli, Dita ndërkombëtare e Ambientit. Në aksion, kanë marrë pjesë, punëtorët e administratës komunale të Malishevës, nxënësit e shkollave të mesme dhe fillore dhe organizatat tjera punuese në Malishevë, kurse është prirë nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj.

Nga ora 10, deri në ora 11:30, janë pastruar të gjitha hapësirat përreth rrugëve, oborret e institucioneve, parqet në qytet, si dhe janë mbjellë drunjt dekorativ në “Sheshin e Dëshmorëve” në Malishevë.

Po ashtu, gjatë ditës së sotme, është duke u bërë grumbullimi i mbeturinave, nëpër fshatra të komunës së Malishevës (aty ku është më e shprehur kjo dukuri), të cilat kompania për menaxhimin e mbeturinave, do ti largoj nga ato vende.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Prilli muaj i ambientit

Malishevë, 4 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, sot në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve, ka bërë të ditur se prilli, do të jetë muaj i ambientit dhe pastërtisë, ku gjatë tërë muajit, do të largohen mbeturinat nga hapësirat publike.

Në këtë kontekst, është kërkuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike hartimi i Planit të Veprimit, në bashkëpunim me Inspektoratin sanitar.

“Kërkoj nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, hartimin e një Plani të Veprimit, në bashkëpunim me inspektorin sanitar dhe kompaninë për menaxhimin e mbeturinave, për pastrimin e ambientit nga mbeturinat, në vendet e shënuara, si “pika të zeza”, ku ka grumbullim të mbeturinave”, tha z. Kilaj kryetar i Komunës së Malishevës.

Po ashtu u kërkuar, që edhe Policia e Kosovës, të ndihmoj në zbatimin e rregullores për mirëmbajtjen e ambientit.

Në këtë mbledhje, u raportua edhe për procesin e regjistrimit, ku sipas koordinаторit Muharrem Morina, “çdo gjë po shkon sipas planit dhe regjistrimi do të kryhet brenda planifikimit”, ndërsa u diskutua edhe për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në Vërmicë, e cila pritet të filloj këto ditë.

Një çështje tjetër e diskutuar sot, ishte edhe përgatitja për spërkatjen e zonave endemike, si masë parandaluese, kundër infektimit nga ethe hemorragjike, pasi që tashmë jemi në fillim të pranverës, kur edhe fillon koha e lajmërimit të rriqrave. Sipas drejtorit për shëndetësi, z. Skënder Hoti, stafi është i përgatitur sikur edhe mjetet për kryerjen e spërkatjes dhe të gjitha do të koordinohen me Institutin Rajonal të Shëndetit Publik në Prizren “.

Kryetari Kilaj priti në takim njohës zyrtarin e lartë të OSBE-s për regjionin e Prizrenit

Malishevë, 6 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim, zyrtarin e lartë të OSBE-s për regjionin e Prizrenit, z. Alessandro Leone. Qëllimi i takimit kishte karakter njohës.

Alessandro Leone, ka falënderuar kryetarin Kilaj, për pritjen, ndërkohë e ka njoftuar atë për veprimtarinë e tij që nga viti 2008, në misionin ndërkombëtar, ndërsa në pozitën që është tani, si zyrtar i lartë në OSBE për regionin e Prizrenit, ka filluar që një muaj. "Unë shpresoj në vazhdimin e bashkëpunimit tonë me ju edhe më tutje", tha z. Leone, duke shprehur njohurinë për bashkëpunimin e mëhershëm, midis komunës së Malishevës, dhe zyrtarët komunal nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Edhe kryetari Kilaj, ka falënderuar zyrtarin Leone, si përfaqësues i OSBE-s, për bashkëpunimin e treguar deri tash, si dhe ka premtuar për bashkëpunim të mëtutjeshëm. "Unë shpresoj që ju gjatë këtij misioni, të sillni përvojat e vendit tuaj", tha mes tjerash kryetari i komunës së Malishevës, i cili më pas njoftoi për projektin që është duke u realizuar së bashku me DEMI-Iniciativa për Komunitet Demokratike dhe Efektive, që ka të bëjë me qeverisje efektive. Kryetari, poashtu ka njoftuar për përbërjen e kuvendit, qeverisë, për mbarëvajtjen e punëve, për harmonizimin e rregulloreve komunale, konform ligjeve në fuqi, me miratimin e buxhetit komunal, por edhe me projekte në ngritjen e infrastrukturës kulturore. Në këtë kontekst z. Kilaj, me interesimin e z. Leone, e njoftoi atë, se vetëm vitin e kaluar janë ndërtuar tre fusha të sportit, është në përfundim Palestra e Sportit, si dhe Shtëpia e Kulturës, ngase sipas zyrtarëve nga OSBE, prioritet për vitin 2011 do të jetë rinia.

Në fund u bë e ditur edhe për takime të tjera që mund të organizohen nga ana e OSBE-s, në lidhje me ngritjen e kapaciteteve të mëtejme të zyrtarëve komunal.

Kryetari Kilaj shpërblen me llaptop fituesin Islam Foniqi

Malishevë, 12 prill

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka shpërblyer me llaptop nxënësin Islam Foniqi, i cili javë më parë kishte zënë vendin e parë në Olimpiadën e Matematikës, në nivel vendi.

"Unë ndihem krenar, sepse Islami na ka nderuar edhe neve si komunë, prandaj i uroj suksese, ndërkohë përgëzoj për të arriturat e tij edhe kujdestarin e klasës z. Ruxhdi Bytyçi dhe drejtorin e Gjimnazit z. Agim Samadraxha", kështu është shprehur në mes tjerash kryetari i Komunës së Malishevës z. Isni Kilaj, përderisa i ka dhuruar një kompjuter (llaptop), nxënësit të klasës së dymbëdhjetë të Gjimnazit "A.Frashëri", të Malishevës.



Me këtë rast, kryetari Kilaj, është falënderuar nga drejtori i Gjimnazit në Malishevë, z. Samadraxha dhe kujdestari i nxënësit, z. Bytyçi, për shpërblimin e dhënë nxënësit Islam Foniqi, por edhe nga gjyshi i Islamit, z. Demir Foniqi, i cili ishte i pranishëm në këtë takim.

Pritet që nxënësi Islami Foniqi, të jetë pjesë e ekipit kosovar, në Olimpiadën e Matematikanëve Ndërkombëtar (IMO), që parashihet të mbahet në korrik të këtij viti në Amsterdam të Holandës.

Nga takimi i KKS-së

Tentim vetëvrasjet mbeten shqetësim

Malishevë, 12 prill

Rastet e tentim vetëvrasjeve, vazhdojnë të mbesin shqetësim, ndërsa rastet e aksidenteve në trafik, falë angazhim të policisë, kanë shënuar rënie, kurse situata e sigorisë së përgjithshme, në territorin e komunës së Malishevës, vazhdonë të jetë e qetë dhe stabile, ka vlerësuar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS).

“Marsi ka qenë muaj i qetë, edhe pse arrestimet e fundit të EULEX-it, e kanë luhatur bilancin e sigorisë. Ne i dënojmë dhe i konsiderojmë arrestime të pabaza, duke e pas parasysh se lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë”, ka thënë Halit Zogaj, drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Edhe Feride Hoxha, anëtare e KKS-së, nga shoqëria civile, në emër të shoqërisë civile të Malishevës, e ka dënuar rastin e arrestimeve të EULEX-it, për pjesëtarët e UÇK-së, duke besuar se drejtësia, do të gjykoj drejtë.

Ndërsa Bekim Begaj, u.d. i komandantit të stacionit në Malishevë, ka falënderuar qytetarët për sjellje korrekte gjatë dy protestave të organizuara, kundër këtyre arrestimeve. “Sa i përket situatës së sigorisë së përgjithshme, mund të them se falë angazhimit të policisë, ka rënie të aksidenteve në trafik, por edhe të veprave tjera të kundërligjshme, ndërsa shqetësuese, mbeten rastet e tentim vetëvrasjeve, pasi për dy muaj, janë shënuar nëntë raste, kurse në prill, një rast ka përfunduar me fatalitet”.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka njoftuar për aksionin e suksesshëm të eliminimit të qenve endacak, aksion i cili do të vazhdoj gjatë tërë vitit, si dhe për përgatitjet për spërkatjen selektive, kundër rriqrave si masë parandaluese, kundër etheve hemorragjike.

Për shkak të mospërgjegjësisë ndaj premtimeve 10-vjeçare ndërpritet bashkëpunimi me PELIKAN-in francez

Malishevë, 12 prill

Për shkak të mospërgjegjësisë ndaj premtimeve tash e 10 vjet, për ndërtimin e një Qendre Kulture Laike Franceze, nga Organizata Joqeveritare "Le Pelikan-agir et Partager" në Malishevës, kryetari i Komunës së Malishevës, Isni Kilaj, ndërpret bashkëpunimin me këtë organizatë.

Tash e 10 vjet më parë, kjo OJQ, ka mbajtur një varg takimesh, për ndërtimin e një Qendre Kulture Laike Franceze në Malishevës, për çka është kërkuar ndarja e lokacionit, e që për këtë qëllim komuna kishte ndarë 20 ari, mirëpo as tash e dhjetë vjet nuk është realizuar nga ana e kësaj OJQ-jë, ndërtimi i Qendrës së lartpërmendur.

Prandaj ne si Komunë e Malishevës, për shkak të mospërgjegjësisë nga ana e PELIKAN-it francez, tërhiqemi nga ndarja e lokacionit, dhe shkëpusimin bashkëpunimin me këtë OJQ.

Mbahet takimi i parë i KOZ-it

Malishevë, 13 prill

Komisioni për Organizimin e Zgjedhjeve (KOZ) në fshatrat e komunë së Malishevës, sot ka mbajtur takimin e parë të punës, ku është diskutuar për hartimin e rregullores për mbajtjen e zgjedhjeve në 43 fshatra si dhe në qytetin dhe lagjet e Malishevës.



KOZ, është i formuar nga Asambleja Komunale dhe ka për obligim hartimin e rregullores dhe organizimin e zgjedhjeve në të gjitha fshatrat e komunës, si dhe monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të zgjedhjeve.

“Zgjedha e kryesive dhe kryetarëve të fshatrave, është shumë e rëndësishme”, ka thënë kryesuesi i Asamblesë Komunale dhe udhëheqës i mbledhjes së këtij komisioni, z.Ragip Begaj.

“Rregullorja duhet të jetë në pajtim me ligjin, udhëzimet administrative dhe statutin e komunës”, tha z.Nuhi Krasniqi, anëtar i komisionit dhe hartues i dy projekt rregulloreve, nga të cilat anëtarët e komisionit, do të nxjerrin një rregullore të përbashkët, e cila më pas do ti dërgohet Asamblesë Komunale, për miratim.

GIZ në Qendrën e Kompetencës në Malishevë

Prezantohet studimi në sektorin e turizmit: specialist i turizmit dhe kuzhinier

Malishevë, 14 prill

GIZ-i gjerman, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, ka bërë një prezantim në lidhje me studimin e profileve: specialist i hotelerisë dhe kuzhinier, në Qendrën e Kompetencës në Malishevë. Qëllimi i prezantimit të këtij studimi, në këtë qendër, ndërlidhet me bashkëpunimin që kjo organizatë ka me Qendrën e Kompetencës dhe profileve që posedon kjo shkollë profesionale në Malishevë.

I pranishëm ishte edhe kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, i cili vlerësoj dhe falënderoj GIZ-in për interesimin e tyre që këtë studim ta prezantojnë në Malishevë. “Një hulumtim i tillë në lidhje me turizmin është i domosdoshëm në Kosovë, ngase do t’i shërbej orientimit të Strategjisë Zhvillimore në këtë drejtim”, tha ndër të tjera kryetari Kilaj.

“Këto prezantime zakonisht bëhen në Prishtinë, mirëpo për arsye bashkëpunimin që GIZ ka me Qendrën e Kompetencës, kësaj here ka vendosur që këtë prezantim ta bëjë këtu”, është shprehur drejtori i kësaj shkolle z. Besim Dobruna, i cili edhe ka falënderuar GIZ-n për bashkëpunim. Sipas z. Dobruna “bashkëpunimi me GIZ-n reflekton edhe me këtë prezantim që kjo organizatë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, ka specifikuar këtë shkollë profesionale për ta shpalosur atë”.

Ndërkohë përfaqësuesi i GIZ-t Rainhard Trenkle, është shprehur të jetë i lumtur që këtë studim e bënë në Malishevë. “Jam i lumtur që sot ndodhem në Qendrën e Kompetencës në Malishevë, për ta prezantuar këtë studim, që ndërlidhet edhe me profilet e kësaj shkolle profesionale”, u shpreh z. Trenkle.

Studimi i ashtuquajtur Bazë në Arsim dhe Aftësim Profesional në Kosovë, në profilet: specialist i hotelerisë dhe kuzhinier, ishte bërë në 21 kompani hoteliere, në lidhje me përshkrimin e përgjithshëm; të gjeturat e përgjithshme në lidhje me specialistin/ën e hotelerisë, të gjeturat e përgjithshme në lidhje me kuzhinierin, etj.

Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

Përfundon me sukses regjistrimi në Malishevë

Malishevë, 18 prill

Në mbledhjen e sotme, të Këshillit të Drejtorëve, e udhëhequr nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, në mesin e temave, është bërë e ditur edhe puna e Komisionit Komunal për Regjistrimin e Popullatës, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Sipas rezultateve të para preliminare, komuna e Malishevë, ka afro 69 mijë banorë, prej tyre, afro 55 mijë banorë rezident, ndërsa 14 mijë jo rezident, pa i llogaritur fëmijët e atyre që punojnë dhe jetojnë, jashtë vendit.

Sipas kryetarit Kilaj, “ky numër i banorëve ka qenë i pritur, sipas parashikimeve të komunës”, ndërsa i tërë procesi, u vlerësua i suksesshëm.

Në mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, kryetari Kilaj, ka njoftuar edhe për angazhimet që po bëhen bashkë me USAID-in, për rregullimin e sistemit të pompimit në stacionin e ujësjellësit në Banjë dhe për mundësinë e ndërtimit të ujësjellësit për fshatin Lladroc.

Ndërsa, drejtori i shërbimeve publike, Alban Kastrati, njoftoi për aksionin e largimit të mbeturinave. “Jam i pakënaqur me mënyrën e largimit të mbeturinave nga ana e kompanisë që është duke kryer këtë aksion”, tha drejtori Kastrati.

Në anën tjetër, drejtori i urbanizimit, Esat Paçarizi, kërkoi që të rishikohet çështja e menaxhimit të kanalizimeve të ujërave atmosferik, pasi kompania e Hidroregjionit Jugor, nuk është duke e bërë pastrimin e pusetave, përderisa sipas drejtorit për buxhet dhe financa, Vesel Krasniqi, komuna paguan faturat ndaj kësaj kompanie, edhe për menaxhimin e kanalizimit të ujërave atmosferik.

Në këtë takim, është njoftuar edhe për çështje tjera, si nga shëndetësia, ku sipas drejtorit për shëndetësi, Skënder Hoti, deri më tani, janë thumbuar 14 persona nga rriqrat, por nuk ka raste të infektuar nga ethet hemorragjike.

Nga kjo javë, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, “do të filloj me një fushatë vetëdijesimi, për parandalimin e zjarreve”, njoftoi, drejtori i kësaj drejtorie, Halit Zogaj.

KPF i rekomandoi kuvendit projekt rregulloren për zgjedhje

Malishevë, 20 prill

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), në mbledhjen e saj të rregullt, ka rekomanduar për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, projekt rregulloren e hartuar nga Komisioni për Organizimin e Zgjedhjeve në fshatrat të komunës së Malishevës.

KPF në këtë mbledhje, ka shqyrtuar dhe ka rekomanduar për shqyrtim dhe miratim këtë projekt rregullore, në mënyrë që të hapet rruga për organizimin e zgjedhjeve nëpër fshatra (kryetarëve dhe kryesive) të komunës së Malishevës.

Po ashtu në këtë mbledhje, përveç procesverbalit nga mbledhja e kaluar janë shqyrtuar edhe disa kërkesa të qytetarëve.

Qeveria e shtetit ndihmon Malishevën në masat parandaluese kundër etheve hemorragjike

Malishevë, 21 prill

Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë do të ndihmojnë Komunën e Malishevës në marrjen e masave parandaluese, kundër etheve hemorragjike, përkatësisht, për spërkatjen selektive të zonave endemike, kundër rriqrave si bartës të virusit të etheve hemorragjike.

“Ministri e Shëndetësisë, na ka konfirmuar ndarjen e një fondit prej njëzet mijë eurove për projektin e spërkatjes së zonave endemike, ndërsa edhe Komuna e Malishevës, ka ndarë një fond prej njëzet mijë eurove për këtë projekt”, ka konfirmuar sot drejtori i Drejtorisë Komunale për Shëndetësi, z.Skënder Hoti.

Konfirmimi i Ministrisë për këtë ndarje të mjeteve, ka ardhur pas kërkesës së Drejtorisë për Shëndetësi, asaj për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Drejtorisë për Bujqësi, dhe pas takimit, që drejtorët e këtyre drejtorive, z. Skënder Hoti dhe z. Halit Zogaj, kanë pasur gjatë ditës së sotme, me zyrtarët e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

“Spërkatja e zonave endemike, këtë vit do të filloj më herët se vitin e kaluar dhe aksioni do të nisë nga java e ardhshme, nëse premtojnë kushtet atmosferike”, tha drejtori Hoti.

U mbajt seminari për vlerësimin e rreziqeve dhe planeve kontingjente

Malishevë, 26 prill

E organizuar nga drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, në bashkëpunim me Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave, sot u mbajt seminari për Vlerësimin e Rreziqeve dhe Planeve Kontingjente, ku u trajtua mënyra e vlerësimit të rreziqeve, menaxhimi i tyre dhe detyrat e zyrtarëve komunal në lidhje me të.

Seminarin, e ka mbajtur, Hajriz Sejdiu, nga Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave (AME), që vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës, ndërsa pjesëmarrës ishin drejtorët e drejtorive komunale, Policisë së Kosovës dhe të Kryqit të Kuq.



Ethet hemorragjike “kime kongo”, vërshimet dhe zjarret, u vlerësuan si tri rreziqet kryesore, me të cilat çdo vit përballlet territori i komunës së Malishevës, dhe për ti menaxhuar këto rreziqe, u shtrua nevoja e krijimit të një fondi për raste të emergjencave.

Po ashtu, u shtrua edhe nevoja e domosdoshme, e “lidhjes së marrëveshjeve të mirëkuptimit, me komunat përreth Malishevës, për ndihmë reciproke, mirëpo, ajo në të cilën duhet të bazohet komuna, janë forcat e saja vetanake për menaxhim të situatave”, tha Hajriz Sejdiu, nga AME.

H.Sejdiu, po ashtu, njoftoi edhe planin në nivel kombëtar për menaxhimin e emergjencave, si dhe shpjegoi planifikimin e kontingjenteve (të papriturave), mënyrën e organizimit, për menaxhimin, zbutjen e fatkeqësive dhe shfrytëzimin e resurseve në menaxhimin e fatkeqësive.

Hapet rruga për zgjedhjet nëpër fshatra

Malishevë, 29 prill



Asambleja Komunale e Malishevës, ka miratuar rregulloren me anë të së cilës, hapet rruga për organizimin e zgjedhjeve nëpër fshatra të komunës së Malishevës. Kjo rregullore është miratuar në mbledhjen e katërmëdhjetë të radhës së këtij legjislacioni, të mbajtur sot.

Mbledhja e sotme, e KK-s, është drejtuar nga kryesuesi z.Ragip Begaj, ndërsa në rend dite, ishte rekomandimi i KPF-së, për

shqyrtimin e kërkesës së një qytetari për dhënien në shfrytëzim të pronës publike, me qëllim të ndërtimit të një çerdhe, por me shumicë të votave të këshilltarëve komunal, është shtyrë për një mbledhje tjetër, të cilët edhe dhanë arsyetimet e tyre në lidhje me këtë.

Në rend dite, ishte edhe shqyrtimi i projekt rregullores për organizimin e zgjedhjeve nëpër fshatra të Komunës së Malishevës, rregullore, e cila ishte hartuar nga komisioni i emëruar nga kuvendi. Bazuar në këtë rregullore, zgjedhjet do të mbahen gjatë muajve maj-qershor.